



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.02.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. AFËRDITA BALAJ AJDINI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Antigona Kqiku.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Afërdita Balaj Ajdini dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 26.02.2020, Nr.265/2020, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Antigona Kqiku, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të marrjes së pozitës në shërbimin civil, zyrtare e pasurisë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirënditur e cila është, znj. Afërdita Balaj Ajdini, ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 28.02.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka